



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , më 03.09.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

ME
OBJEKT

“RIFORCIMI I NJËSISE SË BANIMIT NË NDËRTESEN QE I PERKET, PALLATIT 5.6 DHE 9 KT ME NR PASURIE 3/790, ZK.8621 ME VENDODHJE NE QYTETIN E KRUJES RRUGA “DONIKA KASTRIOTI ”),ME NDERHYRJE REHABILITUESE /PERSHTATESE TE DEMEVE TE SHKAKTUARA NGA TERMETI I DATES 26.11.2019 , NË BAZË TË AKTEKSPERTIZAVE TË THELLUARA”

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot me date 03.09.2026 ne Kruje, nga ana Njesise se Prokurimit i ngritur me urdherin nr.459 datë,03.09.2026 , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Kufizuar ” ne kuader te procesit te rindertimit dhe ne referim te urdherit te prokurimit te sipercituar me te dhenat e procedures si vijon:

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Riforcimi i njësise së banimit në ndërtesen qe i perket, pallatit 5.6 dhe 9 KT me nr pasurie 3/790, ZK.8621 me vendodhje ne Qytetin e Krujes rruga “Donika Kastrioti ”),me nderhyrje rehabilituese /pershtatese te demeve te shkaktuara nga termeti i dates 26.11.2019 , në bazë të aktekspertizave të thelluara”.

LLOJI I PROCEDURES: “E Kufizuar” , ne kuader te procesit te Rindertimit.

LLOJI I PROKURIMIT: Marreveshje Kuader me disa operator ekonomike me afat vlefshmerie 12(dymbedhjte) muaj, ku jo e gjitha kushtet jane percaktuar.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Pune Ndertimi / (45000000-7)

VLERA E FONDIT LIMIT: 163'730'022(njeqind e gjashtedhete e tre milion e shtateqind e tridhete mije e njezet e dy) lekë pa t.v.sh .

BURIMI I FINACIMIT: Buxhetit i Shtetit , Buxhetit i Shtetit , referuar **VKM nr .480 date 26.06.2026 " Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkitë Krujë e Kurbin, dhe caktimin e Bashkive Krujë e Kurbin si njësi zbatuese"**.

AFATI I REALIZIMIT TË PUNIMEVE:12(dymbedhete), muaj nga data fillimit te punimeve .

Procedura e prokurimit do të jetë **"E Kufizuar"** ne kuader te procesit te Rindertimit , e llojit **Marrëveshje Kuadër - me disa operator ekonomik ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 (dymbedhete) muaj** mbështetur në nenin 52 të ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"dhe sipas nenin 60, pika 1/c, nenit 61 pika 1, neni 62, neni 63, neni 64 pika 1/b.ii , neni 65, neni 66 të kreu VII, e VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ", i ndryshuar ,Udhëzimit nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike " e ndryshuar.

Në bazë të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Neni 42; të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" Neni 21, pika 2; si dhe të të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Neni 2, pika 2/c si dhe Neni 78, pika 2 dhe VKM nr .199, datë 4.3.2020" Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit" i ndryshuar me VKM nr.225 date 12.04.2021 . Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; **(do te paraqitet ne fazen e II-te nga operatoret ekonomik)**
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;
- c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5; **(do te paraqitet ne fazen e II-te nga operatoret ekonomik)**
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 11;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;

*g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;
gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë
elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në
Shqipëri*

Argumentimi: Kriteret e pikave si mesiper janë vendosur në përputhje me kërkesat e nenit 42 të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe nenit 76 dhe 77 të Ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr .199, datë 4.3.2020” Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit” i ndryshuar me VKM nr.225 date 12.04.2021 .

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

a)Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kriteri i mesiperm është vendosur në përputhje me kërkesat e nenit 42 të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe nenit 76 dhe 77 të Ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr .199, datë 4.3.2020” Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit” i ndryshuar me VKM nr.225 date 12.04.2021 .

b)Operatori ekonomik duhet të paraqesi, Vertetim/e që provon/jnë shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore ku të jenë përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2026 të lëshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka seline dhe ushtron aktivitet sipas të dhënave në QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve respektive për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore për vitin 2026 për secilin operator).*

c)Operatori ekonomik ofertues nuk duhet të ketë detyrime të papaguara vendore, detyrime të ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime të ngarkuara nga organe të tjera në favor të Bashkise Krujë dhe të Njësive Administrative pjesë përberese të Bashkise Kruje (ish Komuna dhe Bashki që i janë bashkuar Bashkise Krujë), për të përmbushur këtë pikë nga ana e operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqitet-(Deklaratë/Vetëdeklarim të lëshuar nga administratori/përfaqësuesi subjektivit ofertues).

Shenim-Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mesiperm(sipas pikës nr.c) në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni

3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”. Gjithashtu referuar faktit se procedura i perket procesit të rindertimit, argumentimi i kërkesave e kriterëve si me sipër rezulton të jenë bazuar plotësisht në parashikimet Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 42 si dhe referuar Dokumentave Standarte të Tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit e përshpejtuar për kontratat e punës.

2.3.2. Licenca profesionale të shogerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise .

Shoqeria ofertuese duhet të paraqesi licensen e shogerise të vlefshme për pikat dhe klasifikimin si me poshte vijon:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- -NP-1/A→Punime gërmimi në tokë.
- -NP-3/C→Rikonstrukcion e mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- -NS-4/B→Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- -NS-9/B→Punime strukturore speciale.
- -NS-14/A→Impiante të brendshme elektrike, telefonike dhe telekomunikacioni.
- -NS-18/A→Punime topogjeodezike.

Shenim-Licenca duhet të jete leshuar ne perputhje me kërkesat e VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” te ndryshuar .

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise , Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi,

e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008 ” “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoriae kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinëpërkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimit në tokë	Punime gjurmimi në tokë. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve të gjurmimit, sipas zërit nr.2.1, 2.3, 2.4, 2.5, 17.1, 17.2, 18.1, 18.2 të preventivit, referuar dhe shumatores së punimeve të gjurmimit prej 1'559'047 lekë (0-20 milion lekë→ kategoria A sipas lidhjes 4 të klasifikimit të licensave).	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NP -3	Rikonstruksion e mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	Rikonstruksion e mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve të rikonstruksionit, sipas zërit nr.1.1÷1.17, 4.1, 4.3, 5.1÷5.7, 6.1, 6.2, 6.6, 10.1, 10.2, 10.3, 10.5, 10.6, 10.7, 10.8, 10.8*, 17.3÷17.19, 18.3÷18.11, 19.1÷19.4, 20.1÷20.7, 20.8* të preventivit, referuar dhe shumatores së punimeve të	C	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

		rikonstruksionit prej 57'587'665 lekë (51-100 milion lekë→ kategoria C sipas lidhjes 4 të klasifikimit të licensave).		
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve të rifiniturës, sipas zërit nr.7.1÷7.7, 8.1, 8.3, 9.1, 10.22 të preventivit, referuar dhe shumatores së punimeve të rifiniturës prej 48'959'107 lekë (21-50 milion lekë→ kategoria B sipas lidhjes 4 të klasifikimit të licensave).	B	Brenda vleres së kufirit të parashikuar në VKM nr 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NS.9	Punime strukturore speciale.	Punime strukturore speciale. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve strukturore speciale, sipas zërit nr.10.9, 10.10, 10.11, 10.12, 10.16, 10.17, 10.18, 10.19, 10.21, 10.23 të preventivit, referuar dhe shumatores së punimeve strukturore speciale prej 40'292'791 lekë (21-50 milion lekë→ kategoria B sipas lidhjes 4 të klasifikimit të licensave).	B	Brenda vleres së kufirit të parashikuar në VKM nr 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar

NS.14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike dhe telekomunikacioni.	Impiante të brendshme elektrike, telefonike dhe telekomunikacioni. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve elektrike, sipas zërit nr.11.1÷11.7, 12.1÷12.6, 13.6÷13.21, 14.1÷14.13, 15.1*÷15.3*, 16.1*÷15.7*, të preventivit, referuar dhe shumatores së punimeve elektrike prej 7'534'745 lekë (0-20 milion lekë→ kategoria A sipas lidhjes 4 të klasifikimit të licensave).	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar
NS -18	Punime Gjeodezike	Punime topogjeodezike. Kjo pikë kategorie është vendosur për zbatimin e punimeve topogjeodezike, sipas zërit nr.1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9 të punimeve rrugore të preventivit.	A	Brenda vleres se kufirit te parashikuar ne VKM nr 42 date 16.01.2008 i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me prishjen e ndërtesave, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë e mësipërme.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterave ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesojekerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2.b)- Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2023,2024,2025) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vleras e fondit limit te kontrates qe prokurohet përkatësisht: **163’730’022(njeqind e gjashtedhjte e tre milion e shtateqind e tridhjte mije e njezet e dy) lekë pa t.v.sh .**

Shenim-Pika 2.2-b) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.c dhe 55.4** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nen kufirin e ulet monetar dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operateve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

2.2-a) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet financiare (2023,2024,2025),të certifikuara nga autoritetet përkatese kompetente (Drejtore Rajonale te Tatimeve) , që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse ne treguesit e bilanceve per dy vite te njepasnjeshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 42.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Teresia e kriterëve që i perkasin kapacitetit teknik si pjese integrale e kriterëve te vecanta eshte hartuar nga Drejtoria e Planifikimit kontrollit dhe zhvillimit te te territorit (D.P.ZH.T) dhe jane percjelle ne NJ.P.P me shkresen **nr.7140 Prot date 03.09.2026.**

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatorët ekonomik për të provuar pervojën e meparshme të sukseshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshte ne ekzekutimin e kontratave:

2.3.1-Përvojë e sukseshme në ekzekutimin e të paktën:

Operatorët ekonomik për të provuar pervojën e meparshme të sukseshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshte ne ekzekutimin e kontratave te:

a)punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **25% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht ne shumën 40’930’006 (dyzetmilion e nenteqind e tridhjetë mijë e gjashtë) leke pa tvsh** dhe që është realizuar gjatë 5(pese) viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b)punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5(pese) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht, **163’730’022(njehqind e gjashtedhjetë e tre milion e shtateqind e tridhjetë mijë e njezet e dy) lekë pa t.v.sh .**

Shenim- Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme

c)Pika “2.3.1/a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika “2.3.1/b “ duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim:Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

d)Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat dhe dokumentat e mëposhtme provuese:

i-Per punimet e kryera ne sektorin publik duhet te paraqitet dokumentacioni provues te meposhtem si vijon i vlefshem:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 12, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar te objektit ;
- Fatura tatimore perfundimtare te shitjes te deklaruar ne organet tatimore .
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim

ii-Ndersa ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin provues te meposhtem te vlefshem :

- Kontraten e sipermarrjes
- Situacionin përfundimtar te objektit
- Akt kolaudimin e objektit .
- Faturat tatimore te shitjes te deklaruar ne organet tatimore .

(Elmentet provues te mesiperm jane kerkuar ne referim te legjislacionit perkates ne fuqi per disiplinimin e kontrollin e punimeve te ndertimit e me konkretisht ne referencat e dizpozitave te Ligjit Nr.8402, Date 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” i ndryshuar ,dhe VKM nr 408 date Nr. 408, datë 13.5.2015” Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: ”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: ”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

4-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin një vetedeklarim (leshuar nga administratori i shoqërisë ofertuese) që brenda të njëjtes periudhe nuk është kontraktor/nenkontraktor për kontratë /apo kontrata të lidhura me vlera të përbashkëta ose të vecanta jo më e madhe se 100% i kufirit maksimal që disponon kandidati sipas licenses profesionale , të leshuar nga autoriteti kompetent .

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetësinë e deklaratës. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 26 pika 7 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.

5-a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë/staf të punësuar , si më poshtë:

i.	Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
ii.	Inxhinjer Elektrik	1 (një)
iii.	Inxhinjer Gjeodet/Topograf	1 (një)

Për sejcilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqitet ,

- Kontratë pune e vlefshme .
- Diplomë universitare.
- Libreze Pune
- CV .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje afat **kohor prej 12(dymbëdhjetë) muaj** i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate. Kapaciteti per fuqi punetore inxhinierike per stafin e kerkuar inxhinierik bazohet në K.Punës, dhe në V.K.M. nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar dhe lidhet ngushtësisht me nevojën për realizimin në kohë të objektit të kontratës duke iu referuar zbatimit të punimeve, si dhe në perputhje me zerat dhe volumet e punimeve të preventivit sipas projektit të zbatimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe

mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi.**

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c” dhe në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për perballimin e fatkeqesive natyrore”, Neni 42.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Preventivin e Punimeve, Specifikimet Teknike rezulton se është e domosdoshme që Ofertuesi të ketë pjesë të **stafit inxhinieret me profilin e sipercituar në kërkesën për kualifikim**, pasi në preventivin e Punimeve ka zëra pune të cilat shtojnë nevojën për prezencën e profilit teknik të tyre.

7. Personeli dhe fuqia punetore:

a)-Kandidati/ofertuesi/ Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën **46 (dyzet e gjashtë) punonjësve** duke përfshirë personelin teknik , drejtuesit teknik si dhe mbështetës , për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit të deklaratimit tatimor ,duke nisur nga data e hapjes së ofertave/shprehjes së interesit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumente, origjinal ose kopje të njehsuara me origjinalin ose në format elektronik (sipas platformes elektronike publike E-albania), si më poshtë:

- Vertetim të leshuar administratë tatimore kompetente sipas legjislacionit fiskal në fuqi ku të specifikohet nr. total i punonjësve për të cilët derdhet kontribut sigurimi shoqëror/shendetësor sipas legjislacionit në fuqi .

Ose

- Listepagesat për periudhën e mesipërme (E-sig 025) sipas formatit elektronik në përputhje me VKM nr 922 datë 29.12.2014”**Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.** .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje **3(tre) muajt te fundit te deklarimit tatimor nga data e dorezimit te ofertave/shprehjes se interesit** tregon besueshmëri/garanci për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje në periudhën tatimore të **3(tre) muajve te fundit te deklarimit tatimor nga data e dorezimit te ofertave/shprehjes se interesit** tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për njëpunësim të **paktën 46 (dyzet e gjashtë) persona** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike të cmimeve dhe kostot e fuqisë të punëtorëve (nr i tyre dhe profili), si dhe makinerive janë bazuar në përlogaritjet e hartuara nga ana e autoreve të projektit të zbatimit duke mbajtur në konsideratë tërë zërat e preventivit.

8. a)-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2(dy) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator Sonde shpim Pilotash → **1 manovrator**
- Manovrator Autovinçi → **1 manovrator.**

Për çdo profil punonjësi teknik si më sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës) si dhe dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente përkatëse sipas modaliteteve të **urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019**

b)-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë shofere/drejtues mjeti gjithsej **02(dy) punonjes te drejtimit te automjeteve** te profileve te meposhtme:

- Shoferë kamioni→**1 shoferë,**
- Shoferë kamioncine→**1 shofer**

Per cdo profil te shofereve te mesiperm nga ana e operatorit ekonomik pjesemarres duhet te paraqitet si prova apo deshmi te disponimit te tyre dokumentacioni i meposhtem:

- Kontrata individuale punës e vlefshme (pergjate gjithe periudhes se realizimit te kontrates).
- Leja e Drejtimit per kategorine perkatese sipas kerkesave te rregulloreve ne fuqi te miratuara nga autoritetet kompetent publike (e vlefshme).
- Dëshmite e aftesise profesionale ose Certificate te Aftesise Profesionale(CAP)(të vlefshme),lëshuar nga institucionet perkatese/autoritetet kompetente sipas rregullave te qarkullimit rrugor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Kriteri për stafin e drejtuesve te mjeteve motorike dhe atyre te makinerive te renda, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për shoferet/manovratorët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe qarkullimit te mjeteve dhe certifikimit te personelit te drejtuesve te mjeteve te qarkullimit rrugor e makinerive te renda. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i profilit te personelit te mesiperm , është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

9. -Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

I.MAKINERI	Njësia	Sasia	Pronësia
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera

Kamionçinë nën 3.5 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autovinç deri 2.5 Ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Sondë për shpime pilotash me diameter të madh.	copë	1	Pronësi ose me qera
II.PAJISJE			
Betonierë 500l.	copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni sipërfaqësor.	copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni thellësie.	copë	1	Pronësi ose me qera
Matrapik.	copë	1	Pronësi ose me qera
Trapan elektrik.	copë	1	Pronësi ose me qera
Gurë fresibël për prerje/ zmerilime.	copë	1	Pronësi ose me qera
Kompresor.	copë	1	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe.	copë	1	Pronësi ose me qera
Skela metalike.	m2	7000	Pronësi ose me qera
Jelekë fosforeshentë/uniforma pune.	copë	53	Pronësi ose me qera
Kallëp dërrase.(armaturë).	m2	400	Pronësi ose me qera
Prerëse (sharrë) asfalti.	copë	1	Pronësi ose me qera
Tabela rrugore (për punime në rrugë→Pilotat).	copë	4	Pronësi ose me qera

Kokore për punonjësit.	copë	53	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit në pronësi **leja e qarkullimit (e vlefshme)** - b) **çertifikatën e kontrollit teknik** (e vlefshme); c) **siguricionin e detyrueshem të mjetit** sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (i vlefshëm); d) **Çertifikatë transporti mallrash** sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (e vlefshme), Ndërsa për mjete të marra me qira/perdorim krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet/n edhe **kontrata/t përkatëse të qerasë/marrjes në perdorim** e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.
- b) Për mjetet/pajisjet/makinerite të cilat nuk i nënshtrohen detyrimit ligjor për tu regjistruar në regjistra publikë, **kur janë në pronësi**, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton titullin e pronësisë të vlefshëm si kontrata e shitblerjes /akti çdoganimi/ fatura tatimore e blerjes përkatëse/e, **ndërsa për mjete të marra me qera/perdorim** krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerash e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 13, nuk janë të angazhuara në kontratë të tjera nga Autoriteti Kontraktor. *(Mos plotësimi i këtij kriteri përben kusht për skualifikim).*
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në shtojcën 13, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor. *(Mos plotësimi i këtij kriteri përben kusht për skualifikim).*
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve sipas shtojcës 13, në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor (KVO). *(Mos plotësimi i këtij kriteri përben kusht për skualifikim).*
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e

objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar zerave respektiv te punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në analiza të mbeshetur ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne fuqi per disiplinimin e punimeve te ndertimit. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, specialisti perkates eshte mbeshetur teresisht ne analizave teknike te cmimeve dhe kostot e fuqise e punetorise dhe makinerive te hartuara nga ana e autoreve te projektit te zbatimit, ne referim te cdo zeri punimesh i pasqyruar ne preventivin e punimeve.

10-)Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

11.Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO/SSH/UNI 9001:2015** (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë ose European Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- **ISO/SSH/UNI 14001:2015** (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë ose European Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- **ISO/SSH/UNI 45001-2018** (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare ose Europian Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas DST , janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

ISO 9001:2015 -është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015- ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018- është standard ndërkombëtarë, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga

madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe fondit limit .

- Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij.Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
- Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.
- Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te analizave teknike te hartuara nga ana e autoreve te projektit te zbatimit
- Projekti zbatimit, Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe jane pjese e DST.
- Ne çdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne dokumentet e tenderit ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent.
- Shenim: Gjithashtu ne specifikimet teknike te referuara ne dokumentat aktual te ngarkuar , ne pjesen ku citohet teksti..., “**UNI 6132-72, UNI 7163-79,...etj...**”, do te shtohet fjala **ose ekuivalente ose SSH/UNI/ISO** .

Shenim:Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr.216 DT 13.04.2023” Sistemi i Itegruar i Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim”.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

PER NJESINE E PROKURIMIT PUBLIK